

## KOMITETI DREJTUES

Nr. 11 Prot.

Tiranë, 24 janar 2024

### Vendim Nr. 1 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 23 janar 2024, drejtuar nga Presidenti, z. Avni Ponari dhe prezencë të anëtarëve, znj. Migena Plasa, z. Blendi Dibra, z. Juel Jarani, si dhe z. Klevis Kaso, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Komisionet e FSHB-së;
2. Ekipet kombëtare 2024;
3. Kupa e Shqipërisë (M-F) 2024;
4. Të ndryshme.

Komiteti Drejtues diskutoi sipas rendit të ditës duke trajtuar problematikat për secilën pikë të sajë.

### Për sa më sipër KD-ja vendosi:

1. FSHB do të vazhdojë punën me komisionet e mëposhtme, të përbërë si më poshtë:

Komisioni	Kryetar	Anëtar
Disiplina	Klevis Kaso	Franko Bushati dhe Klaudio Ndoja
Apeli	Blendi Dibra	Besmir Iljazi dhe Sajmir Shatku
Kualifikimi & Projekteve	Edera Alibegaj	Kliton Muça dhe Juel Jarani
Gjykimi	Migena Plasa	Arben Kasmi dhe Artan Terihati
Financa & Marketingu	Klevis Kaso	Suela Trushaj dhe Andi Arapi
3x3	Ersi Oruçi	Altin Cico dhe Ajla Gozhdari

2. Ekipet kombëtare.

2.1 Ekipet kombëtare të moshave U20/18/16 djem dhe vajza për vitin 2024 do të formojnë stafet teknike përpara përfundimit të muajit shkurt. Për këtë detyrë caktohet z. Klaudio

Ndoja si “Drejtor Teknik i Ekipeve Kombëtare” duke përcaktuar, si dhe duke përgatitur marrëveshjet e bashkëpunimit me stafet teknike të ekipeve të mëposhtme:

Nr.	Ekipi Kombëtar	Datat e parashikuara	Vendi i organizimit
1	U20 Vajza - Div. B	6 - 14 Korrik 2024	*Pa caktuar
2	*U16 Djem - Div. C	9 - 14 Korrik 2024 / 8 ekipe pjesëmarrëse	Durrës, Shqipëri
3	U16 Vajza - Div. C	9 - 14 Korrik 2024	Gjibraltari
4	U20 Djem - Div. B	13 - 21 Korrik 2024	Rumani
5	*U18 Djem - Div. C	23 - 28 Korrik 2024 / 8 ekipe pjesëmarrëse	Elbasan, Shqipëri
6	U18 Vajza - Div. C	23 - 28 Korrik 2024	Kosovë

2.2 Në kuadër të organizimit të aktiviteteve europiane 16 djem dhe U18 djem, administrata e FSHB-së udhëzohet për të kryer detyrat e mëposhtme sa më parë:

- Realizimi i kërkesave organizative të kampionatit me sallat sportive për ndeshjet dhe stërvitjet;
- Sigurimi i transportit lokal;
- Sigurimi marrëveshjeve paraprake me hotelet për akomodim full board sipas kriterëve të përcaktuara nga FIBA;

2.3 Për ekipin kombëtar U16 vajza, nevojitet të nisë puna për sigurimin e biletave të udhëtimit, si dhe marrja e vizave për udhëtim në Gjibraltari;

2.4 Për ekipin kombëtar meshkuj të rritur do të sigurohet baza materiale e plotë për ndeshjen në transfertë më datë 25.02.2024, kundër ekipit të Armenisë, përfshirë uniformat, kostumet sportive, xhupa, çanta, etj.

3. Komiteti Drejtues diskutoi mbi veprimtarinë e Kupës së Shqipërisë (M-F) 2024, ku organizimi i ndeshjeve ½ finale dhe finale të femrave u zhvilluan nga klubi sportiv Flamurtari, ndërsa të meshkujve u organizuan nga klubi sportiv Tirana në pallatin e sportit “Feti Borova”. U udhëzua financa e FSHB-së për pasqyrimin e premiove në llogaritë e ekipeve finaliste dhe fituese sipas rregullores së aktiviteteve kombëtare të basketbollit;

4. Të ndryshme.

4.1 U udhëzua administrata e FSHB-së për shtim të kujdesit në pasqyrimet e aktiviteteve kombëtare, si dhe përditimet e informacioneve dhe rubrikave në faqen zyrtare të sajë, [www.fshb.basketball](http://www.fshb.basketball)

**Avni Ponari**  
President

**Franko Bushati**  
Sekretar i Përgjithshëm